



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61 paragrafi 61.3. lidhur me nenin 63 paragrafin 63.1.2. të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "International Security Association" Sh.P.K. të datës 17.10.2024 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Loti 1- Sigurimi fizik i ndërtesave komunale dhe shkollave dhe Loti 2- Sigurimi fizik ne objektet shëndetësore- Ri-tender" me nr. të prokurimit 616-24-10100-2-1-1, Komuna e Prishtinës (Autoriteti Kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **MIRAOHET** si e bazuar kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "International Security Association" Sh.P.K. të datës 17.10.2024 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Loti 1- Sigurimi fizik i ndërtesave komunale dhe shkollave dhe Loti 2- Sigurimi fizik ne objektet shëndetësore- Ri-tender" me nr. të prokurimit 616-24-10100-2-1-1.
- II. **DETYROHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të publikoj Formularin për Korigjimin e Gabimeve në Njoftimet e Publikuara përmes të cilit do të bëj korigjimin e kërkesave mbi kapacitetin teknik dhe profesional në dosjen e tenderit sipas të gjeturave të evidentuara më poshtë në këtë vendim.
- III. **NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "International Security Association" Sh.P.K. (tutje "parashtruesi") me datë 17.10.2024 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Loti 1- Sigurimi fizik i ndërtesave komunale dhe shkollave dhe Loti 2- Sigurimi fizik ne objektet shëndetësore- Ri-tender" me nr. të prokurimit 616-24-10100-2-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin merititor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit janë cituar si në vijim: *“Kenj kerkuar nje automjet me drita rrotative vezulkuese, kjo kerkese eshte diskriminuese dhe nuk ka te beje asgje me industri tr sigurise, andaj kerkojme qe kjo kerkese te largohet nga dosja”.*

Lidhur me pretendimet ankimore të parashtruesit, fillimisht duhet cekur se përmes nenit 10 paragrafit 10.3 të RRPP është përcaktuar se njësia kërkuese ndër të tjera ka përgjegjësinë për të përgatitur detyrën projektuese, projektin, specifikimet teknike, termat e referencës, paramasën dhe parallogarinë. Përmes nenit 11 paragrafit 11.3 të RRPP përcaktohet se zyrtari i prokurimit ndër të tjera në bashkëpunim me njësinë kërkuese i koordinon dokumentet, projektet, specifikimet, termat e referencës, paramasat, parallogaritë dhe vizatimet. Në këtë rast zyrtari përgjegjës i prokurimit i ka falur besimin e plotë sqarimeve të ofruara nga njësia kërkuese.

Në rastin konkret përgjigja e njësisë kërkuese është si vijon *“vetëm një kompani e sigurimit posedon leje për vetura me drita vezulluese ... sipas Ligjit Nr. 08/LL-274 për Shërbimet Private të Sigurisë. Sipas Ligjit Nr. 08/LL-274 për Shërbimet Private të Sigurisë dhe akteve nënligjore nuk parashihet që kompanitë private të sigurimit të licencuara për ofrimin e shërbimit themelor të sigurimit, përmes punëtorëve të sigurimit themelor (patrullë), të kane te drejte te tejkalojnë shpejtësinë e lejuar ne komunikacion në mënyrë që veturat patrulluese me drita vezulluese ti mundësojë ndonjë urgjence të caktuar dhe si te tilla janë te pa nevojshme dhe te pa dobishme”.*

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj kërkesa e parashtruesit është miratuar si e bazuar në tërësi dhe AK do të largoj këtë kërkesë nga DT.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. lidhur me nenin 62 par. 62.1. të RRPP. Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 21.10.2024

Visar SHEHU

Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.